



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT

Raporti i Monitorimit të Buxhetit

8 mujori i
vitit 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor

2023

2022

2021

2020

28 shtator 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

RAPORTI

I

MONITORIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – GUSHT 2023

Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2023, janë miratuar në tre programe buxhetore:

- Programi buxhetor 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 01140, “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.
- Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Buxheti i miratuar me ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për të tre programet buxhetore në fillim të vitit ishte në shumën **4,362,600,000 lekë**, i ndarë përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën **324,700,000 lekë**.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën **12,900,000 lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në shumën **4,025,000,000 lekë**.

Krahasuar me vitin 2022 struktura e shpenzimeve sipas programeve ka mbetur e pandryshur edhe për vitin 2023.

Gjatë periudhës raportuese janar-gusht 2023, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar si më poshtë:

- 1) Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor në shumën **4,500,000 lekë**. KLGJ me shkresën nr. 1359, datë 16.02.2023, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar detajimin e këtij fondi në:
 - Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën **1,200,000 lekë**.

- Programi 01140 - "Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë", në shumën **100,000 lekë**.
- Programi 03310 - "Buxheti Gjyqësor", në shumën **3,200,000 lekë**.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023, ka miratuar këtë detajim.

2) Në zbatim të ligjit 33 "Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, VKM nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës", VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", KLGJ me shkresën nr. 3800, datë 05.07.2023 ka paraqitur pranë MFE – së, kërkesën për alokimin e një fondi shtesë në shumën **170,000,000 lekë** për mbulimin e efektit financiar në shpenzime personeli si rezultat i ndryshimeve ligjore të mësipërme.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën 12382/1, datë 18.07.2023 ka miratuar kërkesën e fondit i detajuar ky; **5,000,000 lekë** në programin 01110 (4,000,000 lekë në paga dhe 1,000,000 lekë në sig. shoqërore) dhe **165,000,000 lekë** në programin 03310 (140,000,000 lekë në paga dhe 25,000,000 lekë në sig. shoqërore).

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor "Këshilli i Lartë Gjyqësor", pas ndryshimeve të mësipërme është në shumën **4,537,100,000 lekë**:

- Programi 01110 - "Planifikim, menaxhim dhe administrim" në shumën **330,900,000 lekë**. Realizimi për 8 mujorin e vitit 2023 është në shumën **183,088,498 lekë**, ose në masë **55%** e planit të rishikuar vjetor.
- Programi 01140 - "Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë" në shumën **13,000,000 lekë**. Realizimi për 8 mujorin e vitit 2023 është **2,350,427 lekë**, ose në masën **18%** e planit të rishikuar vjetor.
- Programi 03310 - "Buxheti Gjyqësor" në shumën **4,193,200,000 lekë**. Realizimi për 8 mujorin e vitit 2023 është **2,137,758,484.75 lekë** ose në masën **51%** e planit të rishikuar vjetor.

Për 8 mujorin e vitit 2023 realizimi si grup buxhetor është në shumën **2,323,197,409.75 lekë** ose në masën **51%**, e buxhetit të rishikuar vjetor.

Artikulli 600 (paga) – Në këtë artikulli u programua në fillim të vitit, fondi në shumën **2,619,550,000 lekë**. Ndryshimet ligjore në shpenzime personeli (ligji 33/2023, VKM nr. 325, 326 datë 31.05.2023) u shoqëruan me një efekt të rëndësishëm financiar në këtë artikull. Me kërkesë të KLGJ-së dhe miratim të MFE-s (me shkresat e sipërcituara) është alokuar fondi shtesë në këtë artikull në shumën **144,000,000 lekë** të detajuar **4,000,000 lekë** në programin 01110 dhe **140,000,000 lekë** në programin 03310. Si rezultat i rishikimit të buxhetit, fondi në këtë artikull është në shumën **2,763,550,000 lekë**, ndërsa realizimi për 8 mujorin është në shumën **1,670,445,507 lekë** ose në masën **60%** e buxhetit të rishikuar vjetor.

Artikulli 601 (Sig Shoqërore) – Në fillim të vitit në këtë artikull është programuar fondi në shumën **319,150,000 lekë**, si rezultat i ndryshimit të dispozitave ligjore si më sipër cituar, ky

artikull u rishikua me një shtesë fondi për mbulimin e efektit financiar në shumën **26,000,000 lekë** i detajuar në **1,000,000 lekë** në programin 01110 dhe **25,000,000 lekë** në programin 03310. Buxheti i rishikuar në këtë artikull është **345,150,000 lekë**, realizimi **202,358,576 lekë** ose në masën **59%** e planit të rishikuar vjetor.

Realizimi në këtë masë i fondeve në shpenzime personeli është i lidhur me vakancat e shumta në sistemin gjyqësor. Numri i punonjësve të Sistemit Gjyqësor i miratuar me ligj për vitin 2023, është 1,759 vetë, nga këto; 128 vetë janë punonjës të stafit të KLGJ-së, 6 vetë është numri i punonjësve të QTI-së, 1,595 vetë është organika e stafit gjyqësor dhe 30 janë punonjës shtesë, por të padetajuar akoma. Numri faktik për periudhën janar- gusht 2023 për sistemin gjyqësor është 1,409 vetë, ndërsa mungesat janë 350 vetë (24+4+292+30=350) nga të cilat 24 janë vakancat në KLGJ, 4 janë në QTI, 292 janë në gjykata dhe 30 janë punonjës të miratuar me ligj por të pa detajuar.

Numri i punonjësve të KLGJ-së, i miratuar me ligj është **128** punonjës ndërsa aktualisht janë **104** punonjës, pra ka një mungesë me 24 punonjës, si dhe 4 punonjës të QTI-së që mungojnë, nga 6 punonjës të planifikuar.

Për vitin 2023. numri i miratuar me ligj për programin “Buxheti Gjyqësor”, është 1,595 punonjës nga këto; 408 janë magjistratë dhe 1,187 janë punonjës të administratës gjyqësore, ndërsa faktikisht në fund të muajit gusht në strukturat organike të gjykatave rezultojnë 1,303 punonjës (295 magjistratë dhe 1,008 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me 292 punonjës; nga të cilët 113 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 179 janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga 295 magjistratë, që rezultojnë efektivisht në detyrë 86 prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

Artikulli 602 (Mallra dhe shërbime të tjera) - Programuar në këtë artikull fondi në shumën **683,376,000 lekë**. Gjatë kësaj periudhe ky fond nuk ka patur ndryshime. Realizimi për 8 mujorin e vitit 2023 është në shumën **354,300,990 lekë** ose në masën 52%. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të këtij grupi buxhetor me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta. Janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, shpenzime transporti si dhe shpenzime te tjera operative.

Artikulli 606 Trans. për Buxh. Fam. & Individ - Fondi i programuar në fillim të vitit në këtë artikull ishte **9,524,000 lekë**. Fondi u programua për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, i ndryshuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor në shumën **4,500,000 lekë**. Buxheti i rishikuar për vitin 2023 është **14,024,000 lekë**, ndërsa realizimi faktik është **3,091,388.51 lekë** ose në masën 22% e buxhetit të rishikuar vjetor.

Artikulli 230-231 (Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm) - Fondi i programuar për shpenzime kapitale për grupin buxhetor "Këshilli i Lartë Gjyqësor" është vetëm me financim të brendshëm në shumën 731,000,000 lekë, nga të cilat:

- **Artikulli 230- (kapitale të trupëzuara)** është programuar fondi në shumën **58,600,000 lekë**. Fondi në këtë artikull nuk është realizuar. Është angazhuar një pjesë e tij në shumën 300,000 lekë por realizimi i këtij angazhimi është bërë në muajin shtator.

- **Artikulli 231- (kapitale të trupëzuara)** është programuar fondi në shumën **672,400,000 lekë**. Është angazhur pjesë e fondit në shumën 98,426,025 lekë dhe është realizuar gjatë 8 mujorit fondi në shumën **93,000,948 lekë** ose në masën 14% e buxhetit të vjetor të programuar në këtë artikull.

Realizimi në shpenzime kapitale nga 731,000,000 lekë të programuara është në shumën 93,000,948 lekë, ose në masën 13% të tij. Realizimi në këtë masë ka ardhur si rezultat i çeljes me vonesë nga MFE të fondit, e cila solli vonesë në procedurat e prokurimit. Ndërkohë fondi për "programe software" në shumën 361,800,000 lekë ka qënë tërësisht i ngrirë dhe në muajin gusht u çbllokua vetëm një pjesë e tij në shumën 150,000,000 lekë, ndërsa diferenca e mbetur në shumën 211,800,000 lekë rezulton akoma i ngrirë.

KLJGJ dhe gjykatat vijojnë procedurat e prokurimit dhe realizimit të fondit.

Përveç fondeve buxhetore, gjykatat në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore" si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Drejtësisë nr. 33, datë 29.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore", kanë përdorur edhe një pjesë të të ardhurave të krijuara prej tyre. Për periudhën raportuese, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm për programin 03310 - Buxheti Gjyqësor) është në shumën **6,791,004 lekë**. (Aneksi 1 dhe 1/1)

Në mënyrë analitike performanca e buxhetit në nivel programi paraqitet si më poshtë (Aneksi 2 dhe 2/1):

I- Programi - 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim"

Buxheti i alokuar me ligjin e buxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor në fillim të vitit 2023 ishte në shumën **324,700,000 lekë**, i detajuar përkatësisht në shumën **309,700,000 lekë** në shpenzime korrente dhe **15,000,000 lekë** në shpenzime kapitale të trupëzuara. (artikulli 231).

Buxheti është rishikuar në këtë program si rezultat i alokimit të fondit të veçantë në shumën **1,200,000 lekë** dhe shtesës së fondit në shumën **5,000,000 lekë** (4,000,000 lekë në paga dhe 1,000,000 lekë në sig. shoqërore), të alokuar nga MFE në përgjigje të kërkesës së KLJGJ (me shkresën nr. 3800, datë 05.07.2023) i nevojshëm për mbulimin e efektit financiar si rezultat i ndryshimit të dispozitave ligjore për sistemin e pagave. Në total buxheti në këtë program ka ndryshuar në vlerë absolute në shumën **6,200,000 lekë**

Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën **330,900,000 lekë** nga të cilat **315,900,000 lekë** shpenzime korrente dhe **15,000,000 lekë** në investime.

Realizimi faktik për periudhën raportuese është në shumën **183,088,498 lekë** ose në masën **55%** kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor, nga të cilat **170,895,649 lekë** në shpenzime korrente, ose në masën **54%** dhe **12,192,849 lekë** në shpenzime kapitale ose në masën **81%**.

“Artikulli 600” - Buxheti vjetor i programuar në *“Shpenzime paga”* për këtë program në shumën **209,000,000 lekë** u rishikua si rezultat i shtesës së fondit në vlerën **4,000,000 lekë** në muajin gusht. Buxheti i rishikuar është në shumën **213,000,000 lekë** dhe realizimi faktik i tij është në shumën **129,802,650 lekë** ose në masën **61%**.

“Artikulli 601”- Buxheti i programuar në shpenzime *“Sig. shoqërore dhe shëndetësore”* për këtë program në fillim të vitit në shumën **27,500,000 lekë**, u rishikua me një fond shtesë në shumën **1,000,000 lekë** në muajin gusht. Buxheti i rishikuar vjetor në shumën **28,500,000 lekë** është realizuar në shumën **16,869,354 lekë** ose në masën **59%**.

Numri i punonjësve të KLGJ-së i miratuar me ligj për vitin 2023 është **128** punonjës ndërsa aktualisht në fund të muajit gusht në organikën faktike të KLGJ-së, rezultojnë **104** punonjës pra ka një mungesë me **24** punonjës, që ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”* për këtë program është në shumën **71,700,000 lekë**, ndërsa realizimi faktik është në shumën **23,832,058 lekë** ose në masën **33%**, kundrejt planit të rishikuar vjetor. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të KLGJ-së me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta si dhe janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, etj. Ndërkohë gjatë 8 muajit për nevojat e stafit të KLGJ-së, vijon likuidimi i kontratave me objekt; "Shërbim printimi dhe fotokopjimi", "Shërbim larje automjetesh", "Shërbim mirëmbajtje automjetesh", "Pjesë këmbimi, goma, bateri për automjetet", "Shërbim mirëmbajtje paisje audio - Sallë plenare", "Karburant", vlera e të cilave po likuidohet gradualisht gjatë vitit, në përputhje me kushtet kontraktuale. KLGJ-ja vazhdon procedurat e prokurimit.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë”* për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2023, u detajua fondi në shumën **1,500,000 lekë**. Fondi do të përdoret kryesisht për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë” i ndryshuar. Fondit të detajuar në fillim të vitit në këtë artikull sikurse cituam më sipër ju shtua fondi i veçantë në shumën **1,200,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023.

Buxheti i rishikuar në këtë artikull është në shumën **2,700,000 lekë**. Gjatë 8 muajit është përdorur për nevojat e punonjësve të stafit të KLGJ-së, fondi në shumën **391,587 lekë**, ose në masën **15%** kundrejt planit të rishikuar vjetor.

Fondet në shpenzime korrente sipas buxhetit të rishikuar në shumën **315,900,000 lekë** janë realizuar në shumën **170,895,649 lekë** ose në masën **54%**. Realizimi në shpenzime korrente është i lidhur me produktin kryesor të këtij programi; **Produkti 92901AA** - “Vendime të miratuara”. (Në formatin 2 dhe 3 sistemi reflektohet gabimisht produkti i vjetër “Auditime të kryera”, kurse tek formati 4 është pasqyruar saktë)

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program, është në shumën **15,000,000 lekë**, i detajuar në dy produkte:

- **Produkti M290072 “Pajisje elektronike”** në shumën **14,500,000 lekë**, i cili është programuar për plotësimin e nevojave të KLGJ-së me; “Pajisje audio vizuale; “Pajisje të tjera teknike”; “Pajisje kompjuterike”, “Pajisje të tjera zyre”. Fondi është realizuar në shumën **12,192,849 lekë**, ose në masën 84%. Fondi i realizuar është përdorur për blerjen e pajisje audiovizive në shumën **10,167,249 lekë** dhe pajisje kompjuterike /elektronike në shumën **2,025,600 lekë**.

- **Produkti M290057 “Rikonstruksion”** janë programuar fondet në shumën **500,000 lekë**, të cilat do të përdoren për nevojat e identifikuara për rikonstruksion të ambjenteve të godinës së KLGJ-së dhe përshtatjen e një zyre për Sektorin e Protokoll Arkivës. Fondi nuk është realizuar. KLGJ vijon procedurat e prokurimeve.

II- Programi - 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”

Fondi i akorduar në fillim të vitit si pjesë përbërëse e grupit buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, për këtë program është në shumën **12,900,000 lekë**. Gjatë periudhës janar- gusht 2023, buxheti në këtë program është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **100,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë program është në shumën **13,000,000 lekë**. Realizimi faktik për periudhën raportuese është në shumën **2,350,427 lekë** ose në masën **18%** kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor.

“Artikulli 600” - Buxheti vjetor i programuar në “*Shpenzime paga*”, për këtë program është në shumën **10,850,000 lekë**, realizimi faktik është në shumën **1,746,977 lekë** ose në masën **16%**.

“Artikulli 601”- Buxheti i programuar në shpenzime “*Sig. shoqërore dhe shëndetësor*” për këtë program është në shumën **1,650,000 lekë**, realizimi faktik është në shumën **240,242 lekë** ose në masën **15%**.

Numri i punonjësve të QTI-së i miratuar me ligj për vitin 2023, është **6** punonjës, ndërsa aktualisht janë punësuar vetëm **2** punonjës (Drejtori i QTI-së dhe një specialist), pra ka një mungesë me **4** punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“Artikulli 602” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program është në shumën **376,000 lekë**. Fondi është realizuar në shumën **363,208 lekë** ose në masën **97%**. Fondi është përdorur për kryerjen e shpenzimeve për pagesa “Honorare Bordi”, për anëtarët e Bordit Drejtues të QTI-së. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së këtij fondi për vijim normal të aktivitetit të këtij institucioni deri në përfundim të vitit buxhetor, KLGJ me shkresën nr 4602/1, datë 04.09.2023 ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesën për rishpërndarjen e fondit në shumën **1,200,000 lekë**, nga artikulli 600 (paga) në artikullin 602 (mallra dhe shërbime të tjera).

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” në shumën **24,000 lekë**, do të përdoret kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare. Fondi është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën

100,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02. 2023. Gjatë 8 mujorit, fondi në shumën 124,000 lekë nuk është përdorur.

Fondet në këtë program janë të detajuara në shpenzime korrente dhe janë në funksion të produktit të vetëm të këtij programi që, është **Produkti- 92903AA “Akte të miratuara”**.

Në formatin 2 dhe 3 të sistemit reflektohet gabimisht produkti i vjetër “programe dhe pajisje të STI” ndërsa në formatin 4 ai është pasqyruar saktë

III - Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Fondi i programuar për këtë program në fillim të vitit 2023, në shumën 4,025,000,000 lekë, u rishikua si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën 3,200,000 lekë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023 dhe alokimit të fondit shtesë në shumën 165,000,000 lekë (140,000,000 lekë në paga dhe 25,000,000 lekë në sig.shoq.) miratuar nga MFE me shkresën 12382/1, datë 18.07.2023, fond i cili do të përdoret për mbulimin e efektit financiar që rrjedhin nga ndryshimi i legjislacionit në lidhje më pagën e magistratëve dhe punonjësve të administratës (ligji 33/2023, VKM nr.325, 326 datë 31.05.2023). Në total është rishikuar në shumën 168,200,000 lekë.

Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën 4,193,200,000 lekë; nga të cilat 3,477,200,000 lekë në shpenzime korrente dhe 716,000,000 lekë në shpenzime kapitale.

Realizimi faktik është në shumën 2,137,758,484.75 lekë ose në masën 51% i detajuar 2,056,950,385.75 lekë në shpenzime korrente ose në masën 59% dhe 80,808,099 lekë ose në masën 11% në shpenzime kapitale.

Për periudhën janar-gusht 2023, gjykatat kanë realizuar shpenzime edhe nga të ardhurat e krijuara prej tyre. Në total janë kryer shpenzime nga të ardhurat në shumën 6,791,004 lekë, nga të cilat në shumën 5,079,671 lekë në mallra dhe shërbime (Art.602) dhe në shumën 1,711,333 lekë në shpenzime kapitale (art. 230 në shumën 94,558 lekë dhe art. 231 në shumën 1,616,775 lekë).

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“Artikulli 600” - Në *“Shpenzime paga”*, buxheti vjetor i alokuar për këtë program është në shumën 2,399,700,000 lekë, ndërsa buxheti i rishikuar vjetor si rezultat i shtesës së fondit në shumën 140,000,000 lekë është në shumën 2,539,700,000 lekë. Realizimi në këtë artikull për periudhën raportuese është në shumën 1,538,895,880 lekë, ose në masën 61% e buxhetit të rishikuar vjetor.

“Artikulli 601”- Buxheti fillestar i programuar në shpenzime *“Sig. shoqërore dhe shëndetësore”* për këtë program ishte 290,000,000 lekë. Buxheti i rishikuar si rezultat i shtesës së fondit në shumën 25,000,000 lekë është në shumën 315,000,000 lekë, ndërsa realizimi për periudhën janar-gusht është në shumën 185,248,980 lekë ose në masën 59%

Realizimi në këtë masë është i lidhur me mungesat në sistemin gjyqësor. Për vitin 2023 numri i miratuar me ligj për programin “Buxheti Gjyqësor” është 1,595 punonjës nga këto; 408 janë

magjistratë dhe 1,187 janë punonjës të administratës gjyqësore, ndërsa faktikisht në fund të muajit gusht në strukturat organike të gjykatave rezultojnë 1,303 punonjës (295 magjistratë dhe 1,008 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me 292 punonjës; nga të cilët 113 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 179 janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga 295 magjistratë, që rezultojnë efektivisht në detyrë 86 prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

“Artikulli 602” – Buxheti vjetor i alokuar për vitin 2023 në *“Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”* është në shumën **611,300,000 lekë**. Realizimi është në shumën **330,105,724 lekë**, ose në masën **54%**. Gjykatat gjatë kësaj periudhe, kanë shlyer detyrimet mujore për shërbime si energji elektrike, ujë, telefon, postë dhe shërbimin korrier. Janë likuiduar shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime të tjera speciale si ekzekutime vendime gjyqësore pagesa për ekspertë, avokatë, psikolog, etj. Gjithashtu pjesë e fondeve buxhetore të artikullit 602 *“Shpenzime operative”* janë dhe fondet e detajuara në programin 03310 të KLGJ –së në shumën **245,005,286 lekë**. Gjatë 8 mujorit është realizuar 100% objekti i prokurimit të fondit në shumën **118,326,865 lekë**, i cili është përdorur për likuidimin e kontratave vjetore me objekt; *“Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes në gjykata”*, në shumën **60,990,275 lekë**, *“Shërbime mirëmbajtje të sistemit audio-video në gjykata RDA dhe Backup Chain”*, në shumën **5,385,745 lekë**, *“Shërbim interneti dhe intraneti për KLGJ-në dhe gjykatat”*, në shumën **5,883,161 lekë**, *“Shërbim mirëmbajtje e programit financiar”*, në shumën **2,083,695 lekë**, *“Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe infrastrukturës mbështetëse në gjykata”*, në shumën **27,096,027 lekë**, *“Licença, mirëmbajtje dhe zhvillim për programet M Files dhe SDM Lot”*, në shumën **16,887,962 lekë**, likuidimi i të cilave bëhet në mënyrë pjesore gjatë vitit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë. Gjykatat dhe KLGJ-ja vazhdojnë procedurat e prokurimit.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”* i detajuar me ligjin e buxhetit në këtë program ishte në shumën **8,000,000 lekë**. Fondi është programuar kryesisht për kryerjen e kompesimeve të shpenzimeve të telefonisë celulare, pagesat për gjyqtarët në skemë delegimi si dhe lidhur me përfitimin interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore.

Fondi i akorduar në këtë artikull u rishikua në shumën **3,200,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë artikull është në shumën **11,200,000 lekë**, ndërsa realizimi për 8 mujor është në shumën **2,699,802 lekë**, ose në masën **24%**.

Përveç fondeve buxhetore, gjykatat kanë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat në funksion të aktivitetet të tyre në shumën 5,491,969 lekë

Realizimi i fondit në shpenzime korrente (me fondet e buxhetit si dhe nga të ardhurat) janë të lidhur me realizimin e **Produktit nr. 1 - 92902AA “Çështje të gjykuara”**.

“Artikulli 230+231” Buxheti në shpenzime kapitale me financim të brendshëm për programin 03310 për vitin 2023 në shumën **716,000,000 lekë** është i detajuar, në *“Shpenzime kapitale të patrupëzuara”* Artikullin 230 në shumën **58,600,000 lekë** dhe në *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”* Artikulli 231 në shumën **657,400,000 lekë**.

“Artikulli 230” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Shpenzime kapitale të patrupëzuara”*, në shumën **58,600,000 lekë** është i detajuar vetëm për 1 produkt.

Produkti - M290066 “Hartim projekti”, fondi në shumën **58,600,000 lekë** i detajuar në programin 03310 të KLGJ- së, u programua për hartimin e 4 projekteve, nga të cilat: 1 projekt për rikonstruksionin e dhomës së serverit të 1 gjykate dhe 3 projekte zbatimi për ndërtimin e godinave të 3 gjykatave. Gjykata e Lartë në shumën **30,000,000 lekë**; Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në shumën **20,000,000 lekë** dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në shumën **8,000,000 lekë**. Fondi nuk është realizuar, KLGJ ka kryer detyrën e projektit, por bashkitë nuk kanë vënë në dispozicion sheshe ndërtimi për këto gjykata. Ndërsa fondi në shumën **600,000 lekë** i programuar për projektin e rikonstruksionit të dhomës së serverit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës është angazhuar fondi në shumën **300,000 lekë** dhe është bërë likuidimi tij në muajin shtator.

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”*, për këtë program është në shumën **657,400,000 lekë**, ndërsa realizimi për 8 mujorin është **80,808,099 lekë** ose në masën **12%**. Fondi është i detajuar në 5 produkte si më poshtë:

Produkti - M290068 - “Rikonstruksion”, janë alokuar fondet në shumën **56,500,000 lekë**; nga të cilat për nevojat e 8 gjykatave është detajuar fondi në shumën **52,950,000 lekë**, ndërsa diferenca e fondit në shumën **3,550,000 lekë** që do të administrohet nga KLGJ-ja është menduar të përdoret për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje të godinave të 12 gjykatave të tjera. Fondi nuk është realizuar. Gjykatat kanë filluar procedurat e prokurimit.

Produkti - 21AC501- “Programe Software për gjykatat”, është detajuar fondi në shumën **361,800,000 lekë**, i cili ishte parashikuar të përdorej për realizimin e 10 projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit, në sistemin gjyqësor. Gjithashtu një pjesë e këtij fondi në shumën **14,900,000 lekë**, është detajuar për 3 projekte në vazhdim nga viti 2022 dhe të shtrira gjatë vitit 2023, si projekti Disaster recovery, projekti Regjistri elektronik kombëtar OJF, projekti Infrastruktura mbështetëse për hostimin e sistemit të ri ICMIS. Është realizuar pjesërisht fondi në shumën **59,379,739 lekë**, ose në masën 40% e fondit të çbllokuar në shumën **150,000,000 lekë**, për shlyerjen e 4 projekteve; Pajisje & Program Disaster Recovery 951,835 lekë; Pajisje & Program Digitalizimi i arkivave të gjykatave 22,067,904 lekë, Pajisje & Program Menaxhimi i çështjeve gjyqësore në gjykata 30,360,000 lekë dhe Pajisje & Program Implementimi i regjistrit elektronik OJF 6,000,000 lekë. Diferenca e fondit vijon të jetë e ngrirë.

Produkti - 18AD801 “Blerje orendi e pajisje zyre” për vitin 2023 janë programuar fonde në shumën **189,100,000 lekë**. Fondi në shumën **173,100,000 lekë**, në administrim nga KLGJ-ja, i detajuar për *Projektin e sigurisë për gjykatat*, me kosto totale e këtij projekti në shumën **446,400,000 lekë**, i cili do të mundësonte monitorimin e çështjeve të sigurisë në gjykata nuk u realizua për pamjaftueshmëri kohe pasi fondet u çelën me vonesë. Me kërkesë të KLGJ-së me

shkresën nr. 4299, datë 24.07.2023, miratuar nga MFE me shkresën nr 13654/1, datë 07.08.2023, është paksuar fondi në shumën 173,100,000 lekë në këtë produkt dhe është transferuar në produktin 21AC401. Fondi i rishikuar vjetor në këtë projekt është 16,000,000 lekë i detajuar për 13 institucione. Gjatë 8 mujorit fondi është realizuar në shumën 2,305,160 lekë, ose në maswn 14% e fondit të rishikuar për plotësimin e nevojave për 7 gjykata.

Produkti - 21AC401 “Blerje pajisje elektronike”, u programua në fillim të viti 2023 në këtë produkt, në shumën 20,000,000 lekë, për plotësimin e nevojave të gjykatave me infrastrukturën elektronike (si server, switch, kompjuter, UPS serveri, UPS kompjuteri, printer, sisteme fonie, skaner, fotokopje, diktofon, harddisk, monitor). Buxheti i rishikuar është 193,100,000 lekë si rezultat i shtesës së fondit në vlerën 173,100,000 lekë i transferuar nga produkti 18AD801, sipas kërkesës së KLGJ-së nr. 4299, datë 24.07.2023 dhe miratuar nga MFE me shkresën 13654/1, datë 07.08.2023.

Ky fond në administrim nga KLGJ-ja do të përdoret për realizimin e projektit për regjistrimin video të sallave të gjyqit RDAV, për gjykatat e të gjitha niveleve. Buxheti i rishikuar është 193,100,000 lekë, për plotësimin e nevojave të 20 gjykatave. Buxheti është realizuar pjesërisht në shumën 19,123,200 lekë, ose në maswn 10% e fondit të rishikuar për 20 gjykata, ndërkohë është në proces prokurimi pjesa tjetër e fondit.

Produkti - M290075 “Blerje mjete motorike”, janë programuar në programin 03310 të KLGJ-së, në shumën 30,000,000 lekë. Fondi u programua të përdoret për blerjen e 10 copë automjeteve, për përmirësimin dhe rinovimin e mjeteve të transportit në sistemin gjyqësor. Është obliguar fondi në shumën 26,289,600 lekë për prokurimin e 10 automjeteve dhe është likuiduar vlera e kontraktuar në muajin shtator.

Fondi i planifikuar në shpenzime kapitale (Art 230+231), në këtë program, në shumën 716,000,000 lekë, është realizuar vetëm pjesërisht në shumën 80,808,099 lekë, ose në masën 11% . KLGJ vijon procedurat e prokurimit.

Përveç fondeve buxhetore janë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat si më poshtë ;

Në shpenzime kapitale të patrupëzuara: 94,558 lekë për hartim projekti dhe 1,616,775 lekë në shpenzime kapitale të trupëzuara.

Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve dhe realizimit të treguesve të performancës së programit (Aneksi 3,3/1 dhe 4).

I - Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Qëllimi kryesor për programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” është “Përmirësimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar objektivi: “KLGJ-ja do të angazhohet në vendosjen e standardeve të larta të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të saj si dhe për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të tre nivelet” me tregues performance:

1. Numri i akteve nënligjore të miratuara nga KLGJ-ja në masën 95%.
2. Numri i vlerësimeve etiko-profesionale të magistratëve në masën 69%.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 3 produktet e mëposhtme:

- **Produkti 92901AA** - “Vendime të miratuara” - Njësia matëse - “nr.vendimesh.”

Në fillim të vitit mbështetur në politikën e programit, objektivat dhe stafin, u planifikuan rreth 600 vendime. Gjatë periudhës janar-gusht janë realizuar 472 të tilla ose në masën 79%. Fondet në shpenzime korrente sipas buxhetit të rishikuar për realizimin e këtij produkti janë realizuar në masën 54%. Për realizimin e këtyre vendimeve janë shpenzuar 170,895,649 lekë (që i referohen shpenzimeve korrente) ose janë shpenzuar mesatarisht 362,067 lekë/vendim.

- **Produkti M290072**- “Pajisje elektronike ” (Blerje pajisje) - Njësia matëse – nr. institucioni.

Ky produkt është programuar për nevojat e institucionit të KLGJ-së (1 instit) dhe është realizuar nga 1 i tillë ose në masën 100%, ndërsa realizimi vleror është 84%. Shpenzimet mesatare të programuara për këtë produkt janë 14,500,000 lekë. Për realizimin e këtij produkti janë shpenzuar mesatarisht 12,192,849 lekë, ose në masën 84% të tyre.

- **Produkti M290057** - Rikonstruksion - Njësia matëse – nr. institucioni.

Ky produkt është programuar për 1 institucion dhe nuk është realizuar (pra në terma sasior dhe në terma vleror, realizimi është zero). Shpenzimet mesatare për këtë produkt në fillim të vitit ishin 500,000 lekë. Realizimi sasior dhe vleror i produktit është zero. Shpenzimet mesatare për njësi janë 0.

II- Programin 01140 “Mbështetje për teknologjinë, e sistemit të drejtësisë ”

Programi buxhetor “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” ka për qëllim: “Përcaktimi i prioriteteve, politikave dhe standarteve, në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektivi “Angazhimi i QTI-së, për garantimin e arritjes së standardeve të BE-së për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit” me tregues performance:

Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë në masën 50%.

Për realizimin e këtij treguesi është planifikuar 1 produkt për këtë program:

Produkti 92903AA - “Akte të miratuara”.

Fondet e programara në këtë program janë të detajuara tërësisht në shpenzime korrente dhe janë të lidhura me realizimin e këtij produkti. Për vitin 2023 janë planifikuar të miratohen 20 akte . Gjatë 8 mujorit të parë të vitit janë miratuar 8 akte nga 20 të planikuar ose janë realizuar në masën

40%, ndërsa në vlerë ky realizim është 18%. Për realizimin e këtyre 8 akteve janë shpenzuar 2,350,427 lekë, ose mesatarisht 293,803 lekë për akt.

III - Programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Qëllimi kryesor për programin “Buxheti Gjyqësor” është: “Ofrimi efikas i shërbimeve dhe punë më e mirë në gjykatat e 3 niveleve”

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektivi; “Të përmirësohet ofrimi i shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë, që zhvillojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale”, me tregues performance:

1. Përmirësimi, ose ngritja e sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat përmbushin standardet ndërkombëtare dhe rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, sipas ritmeve të ndryshimeve të teknologjisë, në masën 78%.
2. Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (ndërtesa, mjedise pune), për të garantuar standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ofrimin dinjitoz të shërbimit për publikun, në masën 62%.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 7 produktet e mëposhtme:

- 1- Produkti: 92902AA - “Çështje të gjykuara”
- 2- Produkti: 18AD801 - “Mobilje dhe pajisje”
- 3- Produkti: M290075 - “Blerje mjete motorrike”
- 4- Produkti M290066 - “Hartim Projekti”
- 5- Produkti: M290068 - “Rikonstruksion”
- 6- Produkti: 21AC401 - “Blerje pajisje elektronike”
- 7- Produkti: 21AC501 - “Programe software për gjykatat”

Gjatë vitit 2023 mbështetur në vlerën e fondit të planifikuar për secilin produkt dhe njësisë matëse, shpenzimet mesatare për secilin produkt dhe ndryshimi i tyre gjatë periudhës raportuese paraqitet si më poshtë:

- 1- **Produkti: 92902AA “Çështje të gjykuara”**- Njësia matëse - nr. çështjesh.

Parashikimi i numrit të çështjeve nga ana e gjykatave është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite si edhe në përputhje me situatën specifike në Sistemin Gjyqësor ku në zbatim të VKM nr.495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rrethëve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” është bërë riorganizimi i gjykatave. Për shkak të mungesave në strukturat organike të gjykatave, është rritur ngarkesa e gjyqtarëve me gjykime, të cilat kanë çuar në zgjatjen e afatit të gjykimit.

Numri i çështjeve të parashikuara për vitin 2023, ishte 143,180 çështje. Sipas raportimit nga gjykatat, gjatë 8 mujorit janë realizuar 77,064 të tilla ose 54 % e numrit të planifikuar. Ndërsa realizimi vleror i tyre që lidhet me realizimin e shpenzimeve korrente është në masën 59%. Realizimi në këtë masë është i lidhur me mungesat në sistemin gjyqësor. Për realizimin e 77,064 çështjeve janë shpenzuar 2,056,950,386 lekë, ose 26,691 lekë /çështje.

2- Produkti:18AD801“Mobilje dhe pajisje” -Njësia matëse – nr. institucioni.

Për vitin 2023 u programua fondi për mobilje dhe pajisje për zyra dhe salla gjyqi pajisje sigurie dhe pajisje të tjera për 19 gjykata, në vlerën 189,100,000 lekë. Buxheti i rishikuar në shumën 16,000,000 lekë (fondi i pakësuar në shumën 173,100,000 lekë në këtë produkt ka sjellë edhe rishikimin e numrit të tyre në 13 të tilla). Fondi është realizuar nga 7 gjykata ndërsa gjykatat e tjera janë në proces prokurimi. Fondi është realizuar në masën 54% në terma sasior ndërsa në terma vleror realizimi është 14 %. Për realizimin e këtij produkti nga 7 gjykatat janë shpenzuar 2,305,160 lekë ose janë shpenzuar mesatarisht 329,309 lekë nga çdo gjykatë.

3- Produkti:M290075 “Blerje mjete motorike” -Njësia matëse – nr. mjetesh.

Për vitin 2023 në këtë produkt është programuar fondi në shumën 30,000,000 lekë për prokurimin e 10 automjeteve për nevojat e gjykatave. Për periudhën janar-gusht fondi nuk është realizuar dhe shpenzimet mesatare për këtë produkt janë zero. KLGJ e ka prokuruar fondin dhe ka lidhur kontratën në shumën 26,289,600 lekë për blerjen e 10 automjeteve. Në muajin shtator është bërë edhe likuidimi i shumës së kontraktuar.

4- Produkti M290066 “Projekt zbatimi për godina” - Njësia matëse - nr. Projektsh

